

KRESHTE — RRAPE

Prej kalundit Kallmet të Zadrinës u nismë për në Mirditë po thua një më drekë herë. Ja muarmë dal nga dal të përpjetës dhe pas disa orësh udhëtimi arrimë në majën e qafës së Kresh-tës. Prapa nesh po llinim një pamje fort të bukurë: djellikishre rënë mi fushën e Zadrinës dhe Drini, si një gjarpër, po çkëlqente nga rëzët e djellit. Lark, m' anën e Shkodrës, po dukej nga pak Taraboshi i cili ish mbuluar me ca re të bardha. Kodrat të mëdha e të vogla dhe me ngjy-ra të ndryshme shinin bukurin' e kësaj pa-mjeje. Jo shumë lark prej qafës kishim Majën e Veljes, e cila kish pak dborë. Për këtë majë ekziston një legjendë e cila thotë se në kohërat e motçme, kur tër' ajo tokë qe mby-tur në ujë, kjo shërbente për të lidhur me zin-xir barkat me velje!

Mu në qafë është posta e xhandarmërisë, një kasolle e vogël; me të arrirë atje na del një xhandar i cili na qaset dhe na ze për dore dyke thënë: "A je, si je? a je burrë? a ke mujt? a je loth?" Amerikanin me të zonjën i ze vetëm për dore, kurse mua më përshëndosh si pa-mënyrës malësore: më kap për dore, ve dorën